



ZARIFE PONAL

PËR: SHIPRESA OSMANUJAJ

05.06.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	01.06.2017
REFERENC-Ë:	Nr.98/4
PËR/ZA/TO:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturorë nr.37/2017 të dt. 22.05.2017 për lëndën Adem Kerhanaj nr.04-353-82 për ndërtimin e aneksit të objektit në ndërtesën ekzistuese në ngastrën kadastrale nr. 03275-0

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



270 31.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 37/2017

Datë: 22.05.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i Projektit Ideor për ndërtimin e aneksit të objektit në ngastrën kadastrale 03275 – 0 Z.K. Prizren”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Kjo kërkesë, e palës Adem Kërhanaj nga Prizreni, është drejtuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor e Komunës së Prizrenit në QRTK – Prizren, dhe pastaj më datë 13.04.2017 është pranuar dhe protokoluar në IKMM, me nr.protokoli 153/2017.

Adem Kerhanaj nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për ndërtimin e aneksit të objektit në ngastrën kadastrale nr. 03275-0, në rrugën “Iljaz Kuka”. Etazhiteti i objektit ekzistues është B+P+1+Nk. Objekti gjendet në zonën e VIII të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, ku etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9.5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet 60% e sipërfaqës së parcelës.

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të lëndës si dhe të projektit ideor aprovon projektin për ndërtimin e aneksit, i cili është në përputhshmëri me parametrat e caktuara me Plan të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës,

Rekomandon:

1. Të aprovohet Projekti Ideor për për ndërtimin e aneksit të objektit në ngastrën kadastrale nr. 03275-0, i cili i përmbush kriteret për ndërtim në zonën VIII-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit.
2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

